



E PULLES
PAGUAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Noter Artan Treska.Rr."B.Curri".
Tel. 0382140355. Nr. 320 Rep Nr. 64 Kol

KONTRATE SHITJE
KUOTASH DHE KAPITALESH

Sot me date 01.03.2003, ne Zyren e Noterise Tirane para meje noterit **Artan Treska** me adrese Rruga "Bajram Curri", u paraqiten personalisht palet:

SHITESI: Kristo GANOLLI, i biri i Shefqetit i datelindjes 1972 banues ne Divjake te rrethit Lushnje madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar identifikuar nga pasaporta me nr. 31-54 e, Ortak i vetem dhe Administrator i Shoqerise "LUNDRA" Shpk.

BLERESI: Petrit GANOLLI, i biri i Shefqetit i datelindjes 1969 banues ne Divjake te rrethit Lushnje, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr. 31-54 e.

Te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate :

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 27313 date 05.03.2002 eshte regjistruar si person juridik, Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**LUNDRA**" Sh.p.k. me ortak te vetem dhe Administrator z. **Kristo GANOLLI**. Duke u mbeshtetur ne veprimtarine e shoqerise ne Statutin dhe Kontraten e Themelimit ortaku i vetem zoteron ne emer te shoqerise 100% (njqind perqind) te kapitalit fillestar dhe te kuotave ne shumen 100.000 (njqind mije) lek.

Ne baze te Vendimit Nr.1 te Ortakut te vetem te kesaj shoqerie, date 17.02.2003, z. Kristo GANOLLI i shet z. Petrit GANOLLI 50% te kapitalit fillestar ne shumen 50.000 (pesedhjete mije) lek dhe kuotat e kesaj pjese te shoqerise me vullnet te lire e te plote.

Z. Petrit GANOLLI eshte dakord per blerjen e kapitalit ne masen 50% ne shumen 50.000 (pesedhjete mije) lek te shoqerise se mesiperme.

Se bashku me pranimin e kuotave te kapitalit te shoqerise te blere, (50%) Z. Petrit GANOLLI pranon edhe te gjitha detyrimet ligjore qe ka shoqeria ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore.


Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitje, shitesikristo GANOLLI humbet çdo te drejte pronesie mbi 50% te kapitalit i cili i kalon teresisht z. Petrit GANOLLI.

Ne keto kushte shitesi dhe bleresi behen bashkepronare me te drejta te barabarta te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " LUNDRA" Shpk, duke u shenderuar shoqeria nga shoqeri me ortak te vetem ne shoqeri me dy ortake.

Kjo kontrate u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte ligjore dhe duke qene e bazuar ne ligj vertetohet prej meje noterit

SHITESIT

Kristo GANOLLI



BLERESI

Petrit GANOLLI